



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 222, Datë 30.09.2025

MBI

**DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 71, DATË 22.04.2020,
“MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “KALISI HYDROPOWER” SH.P.K., NË
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC-ET
“VELESHICA 1” ME KAPACITET TË INSTALUAR 5801 KW DHE “VELESHICA 2”,
ME KAPACITET TË INSTALUAR 8116 KW, ME KAPACITET TOTAL TË
INSTALUAR 13917 KW” I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 30.09.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2524 prot., datë 26.09.2025, të Drejtorisë së Politikave të Burimeve të Rinovueshme, “Mbi disa ndryshime në vendimmarrjet e bordit të ERE-s lidhur me plotësimin e kushteve nga subjektet e licencuar në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike.”,

Konstatoi se:

1. Të dhëna mbi shoqërinë “KALISI HYDROPOWER” sh.p.k.

- Me vendimin nr. 71, datë 22.04.2020, i ndryshuar me vendimin nr. 135, datë 10.08.2020, bordi i ERE-s ka licencuar shoqërinë “KALISI HYDROPOWER” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et “Veleshica 1” me kapacitet të instaluar 5801 kW dhe “Veleshica 2” me kapacitet të instaluar 8116 kW, me kapacitet total të instaluar 13,917 kW, për një afat 30-vjeçar.
- Në vendimin nr. 71/2020, i ndryshuar, në pikën 2 është përcaktuar se: “Shoqëria ‘KALISI HYDROPOWER’ sh.p.k., të depozitohet në ERE kontratën e rinovuar të qirasë për truallin ku do të ushtrohet veprimtaria jo më vonë se 3 (tre) muaj përpara përfundimit të afatit të saj.”
- Gjithashtu, në këtë vendim, pika 3 është shfuqizuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 135, datë 10.08.2020, ndërkohë që pika 4 përcakton se: “Mosplotësimi i kushteve të këtij vendimi përbën shkak për rishikimin e tij.”

2. Analiza Ligjore dhe Vlerësimi

- Pas ndryshimeve të miratuara me vendimin e bordit të ERE nr. 220, datë 01.09.2022, në Rregulloren “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, është riformatuar neni 9 i rregullores “Formati dhe dokumentacioni për aplikim”, duke shfuqizuar gërmën “g” të pikës 2 të këtij neni, e cila

përcaktonte se në dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor të paraqitur për aplikim përfshihen dhe dokumentet që vërtetojnë pronësinë e aplikuesit në zonat ku do të shtrihet projekti (kontrata shitblerje, kontrata qiramarrje, akte dhurimi, kontrata premtim shitblerje, marrëveshje me subjekte që kanë në pronësi zonat ku shtrihet projekti për ato veprimtari që përdorin asete për kryerjen e aktivitetit të licencuar).

- Në këto kushte, pika 2 e vendimit nr. 71/2020, e cila lidhet me depozitimin e kontratës së qirasë të rinovuar, nuk gjen më mbështetje në kuadrin rregullator.
- Heqja e kushteve nuk përjashton këtë shoqëri nga detyrimi për të ruajtur në vazhdimësi të drejtën e ligjshme të përdorimit të territorit ku shtrihet veprimtaria e licencuar, në përputhje me kontratat përkatëse ose aktet e pronësisë.
- Duke qenë se pika 3 e vendimit është tashmë e shfuqizuar dhe se pika 4 lidhet me ndjekjen e kushteve të përcaktuara në pikat 2 dhe 3, humbet kuptimi i ekzistencës së saj.
- Në përputhje me nenin 113 të ligjit nr. 44/2015, vlerësohet se pikat 2 dhe 4 të vendimit nr. 71/2020 duhet të shfuqizohen, duke lënë të pandryshuara dispozitat e tjera të vendimit.

3. Nevoja për Ndryshimin e Vendimit

- Në mbështetje të nenit 113 të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon se një akt administrativ mund të shfuqizohet nga organi publik që ka kompetencën për ta nxjerrë, vlerësohet e nevojshme që pikat 2 dhe 4 të vendimit të bordit të ERE nr. 71, datë 22.04.2020, i ndryshuar, të shfuqizohen.
- Ky ndryshim është i nevojshëm për të harmonizuar vendimin me kuadrin e përditësuar rregullator dhe për të siguruar qartësi në kushtet e licencës së shoqërisë “KALISI HYDROPOWER” sh.p.k..

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Pikat 2 dhe 4 të vendimit të bordit të ERE nr. 71, datë 22.04.2020, i ndryshuar, shfuqizohen.
2. Drejtoria e Politikave të Burimeve të Rinovueshme, të njoftojë shoqërinë “KALISI HYDROPOWER” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, FTL sh.a., dhe OSSH sh.a. lidhur me vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI